



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 19 shkurt 2019, në mbledhjen e parë (1) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Veton Vehapi – OSBE.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht ju uroj mirëseardhje, më lejoni të hapi mbledhjen. Para se të fillojmë me punë desha të ju informoj se në ndërkohë më duhet ta lë takimin pasi që në të njëjtën kohë kam takimin me palë, duke filluar nga ora 10:00-12:00. Ky lëshim është bërë në mungesë të koordinimit nga ana e stafit administrativ.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05 dhjetor 2018

U miratua njëzëri

2. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Bislimi.

z. Bekim Bislimi, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile dhe nuk pritet që të eskaloj as në të ardhmen. Jemi në fillim të vitit dhe kemi bërë një analizë në përgjithësi të gjendjes me qëllim të ndërmarrjes së hapave parandalues, për përmirësimin e gjendjes. Në këtë periudhë krahasuar me atë të vitit të kaluar ka trendë të

rënies sa i përket rasteve të raportuara dhe iniciuara nga ana jonë. Sa i përket veprave të dëmtimit të pronës, vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda kemi rënie afër 100%, ndërsa gjendja në komunikacion është e njëjtë sa i përket aksidenteve të raportuara. Në këtë periudhë ngritje kanë shënuar rastet e dhunës në familje, ku kemi bërë një analizë të rasteve të kësaj natyre dhe kemi ardhë në përfundim se te ato familje dhuna ka ekzistuar edhe më parë, por se nuk ka ekzistuar gatishmëria për ti raportuar, ndërsa faktorët shtytës pothuajse janë të njëjtë. Nënvizoi, jemi në kontinuitet të zbatimit të disa planeve operative me qëllim të parandalimit të disa veprave të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë në përgjithësi, kemi identifikuar dhe arrestuar disa persona të dyshuar për vjedhje të rënda, janë gjetur dhe konfiskuar një sasi e konsiderueshme e mjeteve të punës të cilat u janë kthyer pronarëve të ligjshëm. Jemi duke punuar në përmirësimin e gjendjes në komunikacion. Aktualisht jemi me plan konkret, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit për parandalimin e taksive ilegale që operojnë në Komunën e Podujevës. Sa i përket sigurisë në objektet shkollore përgjithësisht është e qetë, me përjashtim të një rasti të raportuar "lëndim" në shkollën " Dëshmorët e Kombit ". Dua të theksoj se kemi bashkëpunim të mirë me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe me stafin udhëheqës të shkollave. Kemi planifikuar mbajtjen e ligjëratave në shkollat fillore dhe të mesme për tema të ndryshme me qëllim të përfitimit të njohurive nga nxënësit, vetëdijesimit të tyre për pasojat e mundshme nga dukuritë negative (siç janë prezenca, përdorimi i narkotikëve, çështja e ekstremizmit, dhuna në familje, siguria në rrugë etj.). duke ju referuar incidentet në mes nxënësve vitin e kaluar, këtë vit kemi planifikuar mbajtjen e një ligjrate me temë " Dhuna në mes bashkëmoshatarëve dhe delikuenca e të miturve" çka besoj se do të ndikoj pozitivisht në të ardhmen.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, gjendja e sigurisë së përgjithshme dhe e qarkullimit të lirë, nga ana e KFOR-it vlerësohet e qetë dhe stabile. Bazuar edhe në raportin e paraqitur nga Komandanti i Policisë gjendja është në trendë pozitiv sa i përket veprave kriminale. Në fushën e sigurisë mandati i KFOR-it do të jetë i njëjti, përndryshe kemi bashkëpunim të mirë me institucionet komunale për gjendjen e sigurisë në Komunë dhe në fund pasi që do të jetë edhe takimi i fundit që do të marr pjesë, pasi do të zëvendësohem, unë ju falënderoj shumë për bashkëpunimin dhe mirëpritjen që e kam hasur këtu.

z. Naim Bajraktari, sot kam kënaqësinë të paraqitem si pjesëtar i Ushtrisë së Kosovës. Që tani jemi duke i marrë kompetencat, ndërsa bashkëpunimi do të thellohet edhe më tutje në të gjitha sferat, që është një lajmë i mirë që i shërben edhe më shumë sigurisë. Jemi duke zhvilluar një event së bashku me organet komunale, nesër e kemi konferencën e fundit planifikuese ushtrimi fushor, që do të mbahet bashkërisht, kështu që pas përfundimit do të japim një analizë pasvepruese dhe besoj se kjo do t'i shërbejë sigurisë dhe aftësisht profesional.

z. Agim Velu, Kryetar i Komunës, gjithashtu uroj formimin e Ushtrisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin e saj. Ju falënderoj për raportet e paraqitura. E hap debatin.

Unë ju kërkoj falje që më duhet ta lë takimin për të vazhduar me punën me palë-qytetarë sipas kohës planifikuar. Me takimin do të vazhdoj Nënkryetari z. Nexhmi Rudari.

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, theksoi, vazhdojmë me pikën e radhës së Rendit të ditës.

3. Miratimi i propozimit të Planit të punës të KKSB-së për vitin 2019 **Informatë për aktivitetet KKSB-së në vitin 2018**

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka kryesuesi i Grupit punues z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi, foli për punën e Grupit punues në hartimin dhe përgatitjen e propozimit të Planit të punës të KKSB-së për vitin 2019.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, me formimin e Ushtrisë së Kosovës, mendoj që në kuadër të Planit të punës të përfshihet edhe raportimi i rregullt nga ana e përfaqësuesit të FSK-së. Pastaj, te pika e masave parandaluese për paraqitjen e ekstremizmit të çfarëdoqoftë, mendoj që prap duhet të kemi aktivitete të ndryshme, masa parandaluese. Komuna e Podujevës me Komunën e Suharekës janë shpallur si komunat më të suksesshme në parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit në nivel vendi, për masat dhe atë që kemi bërë si institucione dhe ne si Këshill, ku jemi marrë si shembull i mirë, andaj është mirë që kjo të vazhdojë dhe të futet në planin e punës për vitin 2019.

z. Naim Bajraktari, theksoi, mendoj që në të ardhmen do duhej të kishim një plan për strehimoret e qytetit, ku ende nuk është bërë diçka në këtë drejtim. Kjo është iniciuar në disa struktura në Nivelin qendror, që janë duke punuar në këtë çështje. Unë po e hap këtë si temë në mënyrë që në të ardhmen objektet e mëdha sipas një plani t'i shfrytëzojmë për çfarëdo shtate të sigurisë, si në raste eventuale të tërmeteve, zjarreve, vërshimeve etj.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, për propozimin e parafolësit presim që kjo të diskutohet në Nivelin qendror, pastaj edhe Komuna të marrë përgjegjësitë që i takojnë, sepse është një çështje për të cilën komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme buxhetore, qoftë të mirëmbajtjes së bodrumve të objekteve kolektive apo të ndërtimit të strehimoreve të reja. Me qëllim të vetëdijesimit mendoj dhe është e nevojshme që Shërbimi i Zjarrfikësve së bashku me Policinë dhe Drejtorinë e Arsimit të fillojnë një trajnim me nxënësit dhe mësindhënësit, në mënyrë që të jenë në dijeni se si të veprojnë në raste emergjente, sikurse janë zjarret, vërshimet, tërmetet etj.

z. Liman Zeqiri, theksoi, pajtoj që në kuadër të Planit të punës të përfshihen dy propozimet e paraqitura nga Nënkyetari i Komunës. Mendoj se duhet të kemi informata të rregullta nga përfaqësuesi i FSK, por edhe nga Këshilli i Bashkësisë Islame duhet të jetë një informatë.

z. Osman Kurtolli, theksoi, që nga viti 2003 kam qenë në kuadër të këtij Këshilli, edhe pse më parë kishte tjetër emërtim. Gjatë kësaj periudhe jemi munduar të japim kontributin në funksion të ngritjes së sigurisë publike në përgjithësi dhe besoj se ky Këshill ka dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh. Kryetari i KBI ndër tjera foli edhe për rastet e thyerjes dhe vjedhjes së xhamive. Theksoi, në 4-5 rastet e vjedhjes kanë vepruar në formë të organizuar.

z. Faik Muçiqi, theksoi, sa i kërket propozimeve të reja për përfshirje në Planin e punës së KKSB-së, mendoj dhe qëllimi ishte që mos të dyfishojmë temat, fjala vjen tema për eksteremizmin do të jetë në vet Planin operativ lokal(2019-2020)sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm(2015-2020), që do të miratohet.

Znj. Donjeta Sheqiri, theksoi, atëherë pasi që në plan të punës nuk është paraparë pikë e veçantë, aktivitet në fushën e parandalimit të ekstremizmit duhet përfshirë në Planin operativ lokal 2019-2020.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, nëse nuk keni diçka tjetër e hedh në votim Propozim Planin e punës së KKSB-së për vitin 2019.

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2018, pas votimit njëzëri rekomandohet për miratim në Kuvendin e komunës, me plotësim: Informatë nga FSK-së për sigurinë në komunë, në çdo takim të Këshillit.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, sa i përket informatës për punën e KKSBB-së, kemi draftin e përgatitur nga grupi punues. Fjalën e ka z. Faik Muçiqi, kryesues i grupit punues.

z. Faik Muçiqi, i informoi të pranishmit për përmbajtjen e dokumentit. Theksoi, Informata përmban të dhënat më kryesore të punëve dhe aktiviteteve të Këshillit për vitin 2018.

Konstatim:

Informata për punët dhe aktivitete e KKSBB-së për vitin 2018 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedohet në Kuvendin e komunës.

3. Të ndryshme

z. Qefser Behrami, theksoi, fillimisht e falënderoj Komandantin e Policisë për angazhimet në fushën e sigurisë publike. Më duhet të përcjell disa vërejtje nga komuniteti i fshatit Kërpimëh, për disa punë të kryera që vlerësohen jo të mira, për çka unë kam bërë ankesa te institucionet e Komunës. Në objektin e vjetër të shkollës në muajin e kaluar është hapur një zjarr nga huliganë. Për objektin shkollor në fjalë kam paraqitur kërkesë, ose të bëhet renovimi i shkollës ose të rrënohet objekti. Vërejtja tjetër është se kompania punëkryese gjatë realizimit të projektit të ndriçimit ka dëmtuar disa shtylla të fushës së sportit, rrethojë e cila është ndërtuar me vetkontribut nga banorët. Ngjashëm kemi rastin të shkollës në fshatin Pakashticë, kompania punëkryese gjatë shtrirjes së rrjetit të kanalizimit ka dëmtuar rrethojën e oborrit të shkollës. Këto ishin ndër vërejtjet më të theksuara.

z. Liman Zeqiri, nëse bazohemi në temat, ne historikisht asnjëherë nuk jemi marrë me ideologji fetare por kemi qenë shembull në botë për mirëkuptim, ndërsjellje, tolerancë fetare dhe këto aktet e fundit që të thehet kisha, xhamia, teqet, konspiracionet dhe personat që nuk ia donë të mirën vendit dhe popullit tonë punojnë me shekuj të na ndajnë në ideologji fetare. Mendoj që këto janë thellë dhe kanë instanca të larta dhe çasje të sigurimeve dhe çarqeve të ndryshme të shërbimeve. Ne si Këshill duhet t'i dënojmë këto akte dhe elemente. Nuk janë të rastësishme sikurse e ceku edhe z. Osman Kurtolli, pra qëllimi është të nxisin pakënaqësi në opinion, sepse përmes këtyre elementeve ngriten edhe ndjenjat e njerzëve.

z. Naime Podvorica, theksoi, dua të shpreh shqetësimin për qentë endacak, prezencën e tyre është shumë e madhe, është shqetësuese dhe paraqesin rrezik në përgjithësi, sidomos për fëmijët dhe nxënësit e shkollave. Është e nevojshme të ndërmerren masa në këtë drejtim, në mënyrë që mos të na persëriten rastet sikurse kemi dy raste e fundit në komunën tonë.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, zgjidhja e problemit të qenve endacak është temë jo vetëm lokale por edhe nacionale dhe fatkeqësisht deri më sot nuk kemi arritur të zgjidhja adekuate edhe përkundër masave të ndërmarra, qoftë masa të ashpra por edhe me masa konform ligjeve të Bashkimit Evropian, por sigurisht edhe për shkak të mungesës së fondeve kjo çështje ka çaluar. Megjithatë ne si Komunë duhet ta ngritim shqetësimin

dhe të kërkojmë edhe nga Niveli qendror të alokojnë fonde shtesë për trajtimin e qenve endacak.

Nëse nuk keni diçka tjetër unë ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 11.00

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0021996/19
Podujevë,
19 shkurt 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**